

VENDIM
Nr. 370, datë 2.7.2025

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 42, DATË 16.1.2008,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE TË
ZBATIMIT, KLASIFIKIMIT DHE DISIPLINIMIT TË SUBJEKTEVE JURIDIKE, QË
USHTROJNË VEPRIMTARI NDËRTIMI”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në rregulloren “Për kriteret e procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, të miratuar me vendimin nr. 42, datë 16.1.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë rregulloren, emërtimi “Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës” zëvendësohet me fjalët “...ministra përgjegjëse për ndërtimin...”.

2. Në të gjithë rregulloren, fjalët “...sektori i licencimit...” zëvendësohen me “...sekretariati teknik...”.

3. Në të gjithë rregulloren, fjala “...bilanc...” zëvendësohet me fjalët “...pasqyra financiare...”.

4. Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

i. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Komisioni i Posaçëm i Dhënies së Licencave Profesionale krijohet sipas këtij vendimi dhe përbëhet nga pesë anëtarë:

i. një përfaqësues nga Kryeministria, i cili është kryetar i Komisionit;

ii. dy përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ndërtimin;

iii. një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën;

iv. një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për energjinë.”.

ii. Pas shkronjës “a” shtohen shkronjat “a/1” dhe “a/2”, me këtë përmbajtje:

“a/1) Përbërja e Komisionit të Posaçëm të Dhënies së Licencave Profesionale, sipas shkronjës “a”, të kësaj pike, pas propozimeve për përfaqësuesit përkatës, miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës për ndërtimin. Nën kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të Komisionit të Posaçëm të Dhënies së Licencave Profesionale.

a/2) Detyrën e sekretariatit teknik të Komisionit e kryen struktura përgjegjëse për licencimin në ministrinë përgjegjëse për ndërtimin.”.

iii. Shkronja “c” shfuqizohet.

iv. Shkronja “ç” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) Anëtarët e Komisionit shpërblehen për pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre në komision sipas akteve nënligjore në fuqi, që përcaktojnë masën e shpërblimit për anëtarët e këshillave, të bordeve apo komisioneve në njësitë e qeverisjes qendrore.”.

b) Në pikën 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

i. Fjalja e dytë, e shkronjës “a”, zëvendësohet me “Komisioni shprehet me vendim brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës nëpërmjet portalit “*e-Albania*” drejt sistemit elektronik të licencimit.”.

ii. Në shkronjën “b” bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

- Togfjalëshi “më pas” zëvendësohet me “më pak”;
- Në fund të shkronjës shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Në rast se në një muaj bëhen më shumë se 2 (dy) mbledhje, kryetari dhe anëtarët e Komisionit nuk shpërblehen për mbledhjet shtesë.”.

iii. Në shkronjën “c”, fjalët “...të dorëzuar deri 7 ditë...” zëvendësohen me “...të ardhur nëpërmjet portalit “*e-Albania*” drejt sistemit elektronik të licencimit deri në 1 (një) ditë...”.

iv. Shkronja “ç” shfuqizohet.

c) Në pikën 3 bëhen këto ndryshime:

i. Paragrafi i parë, i shkronjës “c”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Kur konstatohet se ka kërkesa të shumta në numër, brenda dy ditëve punë, kryetari ose, në mungesë të kryetarit, nënkryetari, thërret jashtë radhe mbledhjen për shqyrtimin e materialit të depozituar deri në 1 (një) ditë kalendarike para fillimit të mbledhjes.”.

ii. Shkronja “ë” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ë) Licencat gjenerohen në sistemin elektronik të licencave me të dhënat e hedhura nga sekretaria, bazuar në vendimet e Komisionit duke marrë vulën elektronike të ministrisë përgjegjëse për ndërtimin, si dhe firmoset me firmën elektronike nga kryetari i komisionit dhe i dërgohet kërkuarit në llogarinë e tij në portalin “*e-Albania*”. Sekretaria, brenda 5 (pesë) ditëve punë nga marrja e vendimit në komisionin e posaçëm të licencimit, hedh të dhënat sipas procesverbalit të mbledhjes së firmosur nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje.”.

ç) Në shkronjën “a”, të pikës 4, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Nënparagrafët I dhe II shfuqizohen.

ii. Nënparagrafi IV ndryshohet, si më poshtë vijon:

“IV. Kur kërkesa ka mangësi apo nuk shoqërohet me dokumentacionin përkatës, sipas kreut VI të kësaj rregulloreje, sekretariati brenda 5 (pesë) ditëve punë nga bërja e kërkesës, njofton kërkuarin, nëpërmjet portalit unik qeveritar “*e-Albania*” për plotësimin e dokumentacionit brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike. Nëse mangësitë dhe dokumentacioni plotësohen brenda afatit të përcaktuar dhe konstatohen nga sekretaria se këto plotësime janë shteruese, afatet e shqyrtimit të kërkesës konsiderohen që nga momenti i bërjes së kërkesës për herë të parë. Në rast se mangësitë e konstatuara nuk plotësohen brenda afatit të përcaktuar, kërkesa i kthehet kërkuarit nëpërmjet sistemit të licencave.”.

iii. Nënparagrafi VI ndryshohet, si më poshtë vijon:

“VI. Përgatit rendin e ditës dhe ua shpërndan anëtarëve të komisionit një ditë para mbledhjes.”.

iv. Në paragrafin e dytë të nënparagrafit V bëhen këto ndryshime:

- Në fjalinë e parë, fjala “...Rekomandimi...” zëvendësohet me “...Propozimi...”.
- Fjalja e dytë shfuqizohet.

v. Në paragrafin VII, fjalët “...2 (dy) ditë pune...” zëvendësohen me “...5 (pesë) ditë pune...”.

vi. Paragrafi X ndryshohet, si më poshtë vijon:

“X. Përditëson të dhënat në regjistrin elektronik të subjekteve të licencuara sipas të dhënave në vendimarrjet për licencat për subjektet dhe dërgon për publikim të gjitha vendimarrjet për licencat për subjektet tregtare në Regjistrin Kombëtar të Licencave dhe Lejeve.”.

vii. Paragrafi IX shfuqizohet.

viii. Paragrafi XI ndryshohet, si më poshtë vijon:

“XI. Arkivimin e dokumentacionit të mbledhjeve të komisionit dhe sekretariatit, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin për arkivat.”

d) Në pikën 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Shkronja “b” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“b) Kur kërkesa është në mbështetje të kësaj rregulloreje, brenda 10 (dhjetë) ditëve, subjekti njoftohet nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, për pranimin e përditësimit për një ose më shumë elemente.”;

ii. Nënparagrafi II, i shkronjës “b”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“II. Ndryshim emërtim shoqërie ose selie.”.

iii. Në nënparagrafin IV, të shkronjës “b”, bëhen këto ndryshime:

- Fjalja e parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Statusin aktiv, të çregjistruar apo të pezulluar sipas të dhënave nga regjistri mbi aktivitetin e shoqërisë, e pasqyruar në regjistrin elektronik të licencave, i cili përditësohet ndërmjet ndërveprimit midis dy sistemeve.”.

- Paragrafi i fundit shfuqizohet.

iv. Shkronja “c” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) Kur kërkesa ka të meta ose dokumentacioni provues nuk është në formën e kërkuar ligjore, brenda 7 (shtatë) ditëve nga dita e ardhjes së kërkesës, subjekti njoftohet nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, për plotësim sipas rastit të dokumentacionit dhe/ose kërkesës brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike. Kur subjekti nuk plotëson dokumentacionin dhe/ose kërkesën brenda afatit të përcaktuar, kërkesa i kthehet kërkuarit nëpërmjet sistemit të licencave.”.

dh) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Lëshimi i dublikatit do të kryhet për licenca të miratuara para datës 1 maj 2022. Kërkesa për lëshimin e dublikatit trajtohet brenda 3 (tri) ditësh pune.”.

5. Në kreun III bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në pikën 1 hiqet fjala “garanci”.

b) Shkronjat “b” dhe “d”, të pikës 1, shfuqizohen.

c) Në pikën 2 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Titulli i pikës 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Elementet e licencës, sipas lidhjes nr. 1;”.

ii. Në shkronjën “a” bëhen këto ndryshime:

- Në paragrafin III, fjala “...identifikimit...” zëvendësohet me “...licencës...”.

- Nënparagrafi IV ndryshohet, si më poshtë vijon:

“IV. Datën e regjistrimit në Regjistrin Profesional (e njëjtë me datën e marrjes së vendimit nga komisioni).”.

- Nënparagrafët VIII dhe IX shfuqizohen.

iii. Shkronja “b” shfuqizohet.

ç) Në shkronjën “c”, të pikës 3, bëhen këto ndryshime:

i. Fjalja e parë, e paragrafit të parë, shfuqizohet;

ii. Fjalja e dytë, e paragrafit të pestë, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Njoftimi ka bashkëlidhur dokumentacionin provues sipas kësaj rregulloreje.”.

6. Në kreun IV bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Paragrafi i parë, i pikës 2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit:

a) Drejtuesit teknikë të shoqërisë mund të jenë të angazhuar në punëmarje tjetër vetëm me kohë të pjesshme dhe kur nuk krijojnë apo kanë konflikt interesi me pozicionin e punës si drejtues teknik, si dhe kur nuk cenojnë vijueshmërinë e punës si drejtues teknik;

b) Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi si drejtues teknik dhe ndalohet të disponojë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit;

c) Kur personat që pranojnë të kryejnë detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë për zbatim, disponojnë licencë profesionale mbikëqyrjeje e kolaudim punimesh zbatimi, ata kanë detyrimin për evidentimin e këtij fakti në dokumentacionin e paraqitur për aplikim, si dhe licenca individuale në fushën e mbikëqyrjes dhe kolaudimit të punimeve të zbatimit pezullohet përpara ose në çastin kur shoqëria në fjalë merr licencën;

ç) Për licencat profesionale për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi hiqet pezullimi sapa personi shkëput marrëdhëniet si drejtues teknik me shoqërinë.”.

b) Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Komisioni shqyrton plotësimin e kriterit arsimor të kërkuesit për licencë, në bazë të fushës së diplomimit të përcaktuar në lidhjen 5 të kësaj rregulloreje.”.

7. Në kreun VI bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Fjalja e parë, e shkronjës “a”, të pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Kërkesa e shoqërisë për pajisje me licencë bëhet nëpërmjet portalit “*e-Albania*” drejt sistemit elektronik të licencimit, sipas formularit të paraqitur në lidhjen nr. 6.”.

b) Në shkronjën “a”, të pikës 3, nënparagrafi i fundit, pas nënparagrafit V, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Kur struktura përgjegjëse për licencimin në fushën e zbatimit të punimeve të ndërtimit pranë ministrisë përgjegjëse për ndërtimin njoftohet nga drejtuesi teknik që është larguar nga shoqëria, nëpërmjet portalit “*e-Albania*” drejt sistemit elektronik të licencimit, struktura përgjegjëse, brenda 7 (shtatë) ditëve, njofton shoqërinë për këtë largim dhe për detyrimin për plotësimin sipas kësaj rregulloreje.”.

c) Në nënparagrafin V, të pikës 3, fjalët “...katër viteve të fundit...” zëvendësohen me “...5 (pesë) viteve të fundit...”.

ç) Në pikën 4 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

i. Në fund të pikës 4 shtohen fjalët “...dhe/ose selie...”.

ii. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Kërkesa për ndryshimin e emrit të shoqërisë ose selisë bëhet sipas formularit të paraqitur në lidhjen nr. 6 dhe ndryshimi zbardhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja e kërkesës nëpërmjet portalit “*e-Albania*” drejt sistemit të licencave.”.

d) Fjalja e dytë, e pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Në këtë rast, drejtuesi ligjor ka përgjegjësi për njoftimin.”.

dh) Në pikën 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. Në paragrafin I, të shkronjës “a”, fjalja “Dokumentacioni i mësipërm paraqitet në origjinal ose i njësuar me origjinalin” zëvendësohet me “Dokumentacioni i mësipërm ngarkohet nëpërmjet shërbimit elektronik në portalin “*e-Albania*” drejt sistemit elektronik të licencave në origjinal ose të njësuar me origjinalin.”.

ii. Nënparagrafi i dytë dhe i tretë, në paragrafin I, të shkronjës “a”, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“Shoqëritë e reja të krijuara nga ndarja duhet të ngarkojnë edhe dokumentacionet e përcaktuara në pikat 1 dhe 8, të kreut VI, të kësaj rregulloreje.”.

iii. Në fjalinë e tretë të shkronjës “b”, fjalët “...që duhet të dorëzohet në komision...” zëvendësohen me “...që ngarkohet nëpërmjet shërbimit elektronik në portalin “*e-Albania*” drejt sistemit elektronik të licencave.”.

iv. Në fund të pikës 6 shtohet fjalja, me këtë përmbajtje:

“Shoqëria e re e krijuar nga bashkimi duhet të ngarkojë edhe dokumentacionet e përcaktuara në pikat 1 dhe 8, të kreut VI, të kësaj rregulloreje.”.

e) Në nënparagrafin IV dhe në nënparagrafin II, të pikës 7, fjalët “...4 vitet e fundit...” dhe “...4 viteve të fundit...” zëvendësohen përkatësisht me “...5 vitet e fundit...” dhe “...5 viteve të fundit...”.

ë) Në pikën 9 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

i. Titulli i pikës 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Ekuivalentimi i licencës së shoqërive të huaja dhe dokumentacioni që duhet plotësuar.”.

ii. Shkronja “a” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Të jenë të regjistruara si degë e shoqërisë së huaj në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas legjislacionit vendas ose të regjistruara në vendin e origjinës. Shoqëritë, të cilat janë të regjistruara në vendin e origjinës, kur ushtrojnë veprimtari tregtare në Shqipëri, zbatojnë legjislacionin vendas. Shoqëritë, të cilat nuk kanë hapur degë në Shqipëri, duhet të dorëzojnë një dokument që vërteton regjistrimin si biznes për kryerjen e aktivitetit të punimeve të zbatimit në ndërtim nga vendi i origjinës. (dokumentacioni i apostiluar, i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën shqipe).”.

iii. Pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1)”, me këtë përmbajtje:

“a/1) Licencën (ose dokumentin që shërben si licencë për ushtrimin e aktivitetit profesional përkatës), që disponon shoqëria dhe drejtuesit teknikë të shoqërisë në vendin e origjinës, të njësuar sipas dispozitave në fuqi (noter të vendit të origjinës/apostilë/etj.) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar (në rast se kërkohet edhe pjesë të legjislacionit përkatës të atij vendi, i nevojshëm për të bërë njësimin). Nëse në licencën që disponon nuk përcaktohen kategoritë dhe klasifikimi, atëherë duhet të paraqesë punimet e 4 (katër) viteve të fundit të shoqërisë mëmë, me situacione dhe akte kolaudimi apo të marrjes në dorëzim të objekteve ose dokumentacion tjetër që vërteton kryerjen e punimeve (të pasqyrohen në tabelën sipas lidhjes nr. 8).”.

8. Kreu VII, “Sanksione”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“KREU VII SANKSIONE

1. Ndaj subjekteve të licencuara për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje aplikohen nga komisioni këto masa administrative:

a) vërejtje me paralajmërim për heqjen e licencës për ushtrimin e profesionit kur konstatohen ose provohen deklarime (sipas parashikimeve në këtë rregullore) të rreme, dokumente të pavërteta të subjektit deklarues;

b) pezullim i licencës për një vit kur shoqëria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore;

c) heqje e licencës për 1 vit, në rast se brenda 5 (pesë) vjetëve nga marrja e masës subjektet përsërisin shkeljen për të cilën kanë marrë masë sipas shkronjës “a”, të kësaj pike;

ç) heqjen e licencës për 3 (tre) vjet, në rast se brenda 5 (pesë) vjetëve nga marrja e masës, subjektet përsërisin shkeljen për të cilën kanë marrë masë sipas shkronjës “b”, të kësaj pike.”.

9. Kreu VIII, “Ankimi” ndryshohet, si më poshtë vijon:

“KREU VIII ANKIMI

1. Subjektet e interesuara kanë të drejtën e ankimit pranë Komisionit për çdo vendim që ky i fundit ka marrë, përveç atyre vendimeve që lidhen me sanksionet e parashikuara në kreun VII, të kësaj

rregulloreje. Afati kohor për të bërë ankimin sipas kësaj pike është brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

2. Komisioni për ankimet, që bëhen sipas pikës 1, të këtij kreu, vendos brenda 20 (njëzet) ditëve për pranimin ose mospranimin e ankesës.

3. Në rast të mospranimit të ankesës, subjektet e interesuara, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit, kanë të drejtën e ankimit pranë ministrit përgjegjës. Ministri pasi merr në shqyrtim ankesën e paraqitur nga subjekti, vendos, brenda 20 (njëzet) ditëve, për mospranimin ose kthimin për rishqyrtim të vendimit të marrë në Komision.

4. Subjektet e interesuara kanë të drejtën e ankimit pranë ministrit përgjegjës për çdo vendim të Komisionit për sanksione sipas kreut VII të kësaj rregulloreje. Afati kohor për të bërë ankimin sipas kësaj pike është brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

5. Ministri përgjegjës për ankimin sipas pikës 4, të këtij kreu, vendos brenda 20 (njëzet) ditëve për mospranimin ose kthimin për rishqyrtim të vendimit të marrë në Komision.”.

10. Në kreun III, pika 1, shkronja “a”, nënparagrafi II, në kreun V, pika 1, shkronja “a” dhe nënparagrafi II, në kreun VI, pika 7, nënparagrafi IV, në shkronjën “a” të pikës 9, të kreut VI dhe në lidhjen nr. 8, të vendimit, fjalët “...punimet e 4 (katër) viteve të fundit...” zëvendësohen me “...punimet e 5 (pesë) viteve të fundit...”.

11. Lidhjet e projektvendimit ndryshohen, si më poshtë vijon:

a) Lidhja 1 zëvendësohet me lidhjen 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

b) Lidhja 2 zëvendësohet me lidhjen 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

c) Lidhja 3 zëvendësohet me lidhjen 3, bashkëlidhur këtij vendimi.

ç) Lidhja 5 zëvendësohet me lidhjen 5, bashkëlidhur këtij vendimi.

d) Lidhja 6 zëvendësohet me lidhjen 6, bashkëlidhur këtij vendimi.

dh) Në lidhjen 7, vetëdeklarimi 7/2 zëvendësohet me vetëdeklarimin 7/2 sipas këtij vendimi.

e) Vetëdeklarimi 7/3 në lidhjen 7 shfuqizohet.

12. Në fund të lidhjes 8 shtohet kategoria/punimi NS21 “Impiante të trajtimit të ujërave të zeza”.

II. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lidhja 1. Formati i licencës

LICENCË
NZ.XXXX

SHOQËRIA:	“XXXXXX”
DREJTUES LIGJOR:	XXXXXX XXXXX
DREJTUES TEKNIK:	XXXXXX XXXXX
REZIDENCA:	XXXXXX
<i>Regjistruar në Regjistrin themeltar që nga data:</i> XX.XX.XXXX	

Kategori	Klasifikim	Emërtimi i kategorisë
NP-1	X	Punime gjurmimi në tokë
NP-2	X	Ndërtime civile dhe industriale
NP-3	X	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada

NP-4	X	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale
NP-5	X	Punime nëntokësore, ura e vepra arti
NP-6	X	Diga dhe tunele hidroteknike
NP-7	X	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje
NP-8	X	Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë
NP-9	X	Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime
NP-10	X	Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike
NP-11	X	Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
NP-12	X	Punime të inxhinierisë së mjedisit
NS-1	X	Punime për prishjen e ndërtimeve
NS-2	X	Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
NS-3	X	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë levizëse, transportues)
NS-4	X	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
NS-5	X	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut
NS-6	X	Sinjalistika rrugore jondriçuese
NS-7	X	Barrierra dhe mbrojtje rrugore
NS-8	X	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
NS-9	X	Punime strukturorë speciale
NS-10	X	Shtresa dhe mbistruktura speciale
NS-11	X	Punime mbi shina dhe traversa
NS-12	X	Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit
NS-13	X	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
NS-14	X	Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
NS-15	X	Pastrimi i ujërave detarë, liqenorë dhe lumorë
NS-16	X	Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij
NS-17	X	Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane
NS-18	X	Punime topogjeodezike
NS-19	X	Sisteme kundra zhurmës për infrastrukturë
NS-20	X	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë
NS-21	X	Impiante të trajtimit të ujërave të zeza

**KRYETAR
KOMISIONI
XXXXX XXXXX**

Shënim. Kjo licencë është e vlefshme deri më XX.XX.XXXX.

Lidhja 2

TABELA. KATEGORIZIMI SIPAS PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P – 1	Punime gjurmimi në tokë
N.P – 2	Ndërtime civile dhe industriale
N.P – 3	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
N.P – 4	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
N.P – 5	Punime nëntokësore, ura e vepra arti
N.P – 6	Diga dhe tunele hidroteknike
N.P – 7	Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje
N.P – 8	Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë
N.P – 9	Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime

- N.P – 10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike
- N.P – 11 Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- N.P – 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

- N.S – 1 Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S– 2 Impiante hidrotermosanitare dhe mirëmbajtja e tyre
- N.S – 3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- N.S – 4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese
- N.S – 5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut
- N.S – 6 Sinjalistika rrugore jondriçuese
- N.S – 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore
- N.S – 8 Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri
- N.S – 9 Punime strukturore speciale
- N.S – 10 Shtresa dhe mbistruktura speciale
- N.S – 11 Punime mbi shina dhe traversa
- N.S – 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit
- N.S – 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
- N.S – 14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- N.S – 15 Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore
- N.S – 16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij
- N.S – 17 Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane
- N.S – 18 Punime topogjeodezike
- N.S – 19 Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë
- N.S – 20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë
- N.S – 21 Impiante të trajtimit të ujërave të zeza

Lidhja 3. Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme

N.P. 1 Punime gjërmimi në tokë

Konsiderohen gjërmimet, sistemit dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloji mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gjërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorishte ose shkëmbore.

N.P. 2 Ndërtime civile e industriale

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

N.P. 3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

N.P. 4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar rrugët, pavarësisht nga shkalla e tyre e rëndësisë, autostradat, superstradat përfshirë ndërhyrjet në pika të veçanta, tunelet, devijimet në nivele dhe në lartësi, parkimet, punime të mureve mbajtëse, hekurudha, metro, hekurudhë me kavo, tramvaj, pista aeroportuale, sheshet e helikopterëve, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme të thjeshtë dhe të parandëruar, parafabrikat ose të prodhuar në objekt.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturim i ndërhyrjeve në rrjetin rrugor të nevojshëm për të ndjerë paqëndrueshmërinë mbi “goma”, “hekur”, “zona”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësuese ose pajisje edhe e tipit të veçantë, të linjës hekurudhore.

N.P. 5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti

Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndërhyrjeve nëntokë që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntokësore, tunele.

N.P. 6: Diga dhe tunele hidroteknike.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për të ruajtur ujin e grumbulluar të zbatuar për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes. Përfshin diga të ndërtuara me çfarëdo lloj materiali.

N.P. 7: Ujësjellësi, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin “e shërbimit hidrik kompleks” ose për transportimin në vendet e përdorimit të gazrave, vajrave dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, impiantet e trajtimit të ujit të pijshëm, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

N.P. 8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta të realizuara në ujëra të ëmbla ose të kripura, që i përkasin terminaleve “ujore” ose vepra mbrojtëse territori nga ujërat detare ose të ëmbla, e kompletuar me veprat lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe të tipit të veçantë për të pasur një shërbim të mirë të përdoruesit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar portet, molet, bankinat, panelet, platformat, pontilet, mbrojtje detare, shkëmbinj nënujore, ujësjellësit nënujorë, vepra shkarkimi, si edhe punime të drenimit e thellimi në det të hapur, në pellg ujëmbledhës, të mbrojtjes kundër erozionit nga ujërat e ëmbla ose të kripura.

N.P. 9 Punime mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta ose në rrjet, sido që të jenë realizuar, të nevojshëm për sistemimin e rrjedhjes së ujërave natyrale ose artificiale si edhe për mbrojtjen e territorit nga këto ujëra, të kompletuara me punimet lidhëse të nevojshme.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar kanale lundruese, grykëderdhjet e lumenjve, konsolidimin e strukturave të anëve të lumenjve dhe përrenjve, argjinatura të llojeve të ndryshme, sistemimin dhe vendosjen e regjimit hidraulik të ujërave sipërfaqësore të veprave të diafragmave të argjinaturave dhe

qëndrueshmërisë së shpateve.

N.P.10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, ose që janë të nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike, të kompletuara me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, përfshirë edhe të gjitha impiantet mekanike, elektromekanike elektrike, telefonike, elektronike, të nevojshme për funksionim, sigurim dhe asistencë.

Përfshin hidrocentralet dhe termocentralet.

N.P.11 Ndërtime për nënstacione, kabinat e transformacionit linjat e T/N dhe tensionit të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshëm për shpërndarjen e T/N dhe tensionit të mesëm dhe për transformimin dhe shpërndarjen e tensionit të ulët deri te përdoruesit e energjisë elektrike, të kompletuar me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar centrale dhe kabina transformacioni, shtyllat metalike të nevojshme për transportin dhe shpërndarjen e çfarëdo lloji tensioni, furnizimin dhe vendosjen në vepër të linjave elektrike për çfarëdo numër fazash elektrike, ajrore ose tokësore.

N.P. 12 Punime të inxhinierisë së mjedisit

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrit hidrogeologjikë nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

SHPJEGIME PËR KATEGORITË E NDËRTIMEVE (PUNIMEVE) SPECIALE

N.S –1 Punime për prishjen e ndërtimeve

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshirë edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

N.S-2 Impiante hidrotermosantare dhe mirëmbajtja e tyre

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosantare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dymëve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me

dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.

N.S – 5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike dhe ristrukturimi i impiantit automatik për sinjalistikën ndriçuese dhe sigurinë e trafikut rrugor, hekurudhor, të metrosë ose tramvajit, përfshi përpunimin e informacionit dhe të dhënave.

N.S - 6: Sinjalistika rrugore jondriçuese

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja, ristrukturimi dhe kryerja e sinjalistikës rrugore jondriçuese, vertikale, horizontale dhe komplementare.

N.S – 7 Barriera dhe mbrojtje rrugore

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja ristrukturimi i elementeve, si: *guard rail, new jersey*, zvogëluarit e zhurmave, barrierat në kthesa dhe të ngjashme, të realizuar për të siguruar fluksin e mjeteve rrugore dhe për të mbrojtur rënien në kthesa.

N.S – 8 Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri

Përfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur.

Prodhimin në kantier dhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër.

Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.

N.S- 9 Punime strukturore speciale

Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotave të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilota ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratoriale nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizim dhe konsolidim në terreneve.

N.S- 10 Shtresa dhe mbistruktura speciale

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i shtresave (dysHEMEVE) të realizuara me materiale të veçanta, natyrore ose artificiale, të cilat janë me ngarkesa të konsiderueshme, siç mund të jenë pistat aeroportuale.

N.S – 11 Punime në shina dhe traversa

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja sistematike, ristrukturimi i binarëve për çfarëdo lloj hekurudhe, metroje, tramvaji, si edhe sistemin e frenimit dhe automatizimin e stacioneve të mallrave.

N.S - 12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit

Konsiderohen montimi dhe mirëmbajtja ose ristrukturimi i një sistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punime murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.

N.S - 13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionit me frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me

çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, TV

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

N.S.- 15 Pastrimi i ujerave detare, liqenore dhe lumore

Konsiderohet pastrimi me mjete teknike speciale të veçanta të çfarëdo lloji uji dhe të transportit të materialeve që dalin nga pastrimi i tij në vende të caktuara me akte normative.

N.S.- 16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujit të pijshëm, të ujërave që duhen pastruar, përfshirë edhe grumbullimin e biogazit dhe të prodhimit të energjisë elektrike e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet.

N.S - 17 Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane

Konsiderohet zbatimi dhe mirëmbajtja e zakonshme ose e jashtëzakonshme, e impiantit të djegies së mbetjeve i lidhur me sistemin e trajtimit të tymrave, e ripërdorimit të materialeve përfshirë makineritë e seleksionimit, kompostimin dhe prodhimin e derivateve të djegshme nga mbetjet, e kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet.

N.S - 18 Punime topogjeodezike

Konsiderohet zbatimi i rlevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.

N.S - 19 Sistemi i mbrojtjes nga zhurmat në infrastrukturë

Konsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zëizoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve.

N.S- 20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë:

Përfshihen shpimet për të vlerësuar gjeologjinë për ndërtimin e objektit inxhinierik, shpimet për ujë dhe puse.

NS-21 Impiante të trajtimit të ujërave të zeza.

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja, ristrukturimi i impianteve të ujërave të zeza që duhen trajtuar, kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmës, të veçanta ose në rrjet.

Lidhja nr. 5

Nr.	Fusha në të cilën kërkohet diplomimi
1	Ndërtim
2	Mekanik
3	Elektrik
4	Gjeologji Minierë

Lidhja 6. Formulari 5/1

EMËRTIMI I SHOQËRISË QË KËRKON LICENCIM

Rezidenca/adresa e plote, _____

Telefon / mobil / e-mail _____

Përfaqësues ligjor _____

(emër, atësi, mbiemër)

Drejtues teknik (me të cilët kërkon të marrë licencën)
ekzistues / ikën / shtohet

1. _____ ☐ ☐ ☐
(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)

2. _____ ☐ ☐ ☐
(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)

3. _____ ☐ ☐ ☐
(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)

4. _____ ☐ ☐ ☐
(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)

5. _____ ☐ ☐ ☐
(emër, atësi, mbiemër, titull diplome, vit diplomimi)

(vendosni shenjë në kutinë në krah të aplikimit që kryeni)

APLIKON PËR:

LICENCË PËR HERË TË PARË PËR SHOQËRI NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	
SHTESË NË KATEGORITË E LICENCËS NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	
ZGJATJE AFATI PËR LICENCË SHOQËRIE NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	
NDRYSHIM DHE SHTESË DREJTUESI LIGJOR NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	
NDRYSHIM DHE SHTESË TË DREJTUESIT TEKNIK NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	
NDRYSHIM I EMRIT TË SHOQËRISË NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	
PAJISJE ME DUBLIKATË TË LICENCËS SË SHOQËRISË NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	
RILICENCIMI NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	
NDRYSHIM NË SHKALLËN E KLASIFIKIMIT TË KATEGORIVE NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	
EKUIVALENTIM I LICENCËS PROFESIONALE PËR SUBJEKTET	

QË DISPONOJNË LICENCË PROFESIONALE NË VENDIN E ORIGJINËS (JO SHQIPËRI) NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	
PAJISJE ME LICENCË NË RASTIN KUR KA NDARJE/BASHKIM TË SHOQËRISË/SHOQËRIVE NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	
PAJISJE ME DUBLIKATË TË LICENCËS SË SHOQËRISË NË FUSHËN E ZBATIMIT NË NDËRTIM	

Deklaroj se angazhohem të njohë e të zbatoj në veprimtarinë e shoqërisë KTZ, STASH dhe të gjitha ligjet në fuqi në fushën e ndërtimit si dhe të dërgojë informacion periodik për veprimtarinë e shoqërisë. Jam në dijeni të të gjitha pasojave që mund të kem si rezultat i deklarimeve të rreme apo paraqitjes së dokumenteve të pavërteta.

SHENIM:Për çdo informacion shtese për te cilin nuk ka vend për tu paraqitur, përdorni një flete te bardhe dhe pasi ta nënshkruani, bashkëlidheni këtij formulari

Drejtuesi ligjor

Lidhja 7. Vetëdeklarimi 7/2

VETËDEKLARIMI 7/2

“Deklaroj në përgjegjësinë time, në njohje të plotë të pasojave që sjell një deklaram i pavërtetë se:

Nuk kam asnjë çështje gjyqësore të hapur dhe nuk jam në ndjekje penale nga organet e prokurorisë në lidhje me profesionin ku kërkoj të licencohem (ose në rast se ka – deklaroj: Kam çështje gjyqësore të hapur në gjykatën e rrethit _____ (shoqëruar me motivin e çështjes) apo/ dhe jam në ndjekje penale nga organi i prokurorisë së rrethit _____ (shoqëruar me motivin e ndjekjes)”.

Nuk jam i punësuar në asnjë punëmarrje tjetër me kohë të plotë jashtë këtij subjekti ku aplikoj.

Deklarnesi

(emër, mbiemër, firma)